

VENDIM
Nr.611, datë 21.12.1999

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË ADMINISTRIMIT NË SHOQËRINË “FLORA & CO”
DHE KALIMIN E DOKUMENTACIONIT TË KONTROLLIT DHE TË ADMINISTRIMIT
ORGANIT TË HETIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 dhe 15 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Procesi i administrimit në shoqërinë “Flora&Co” konsiderohet i përfunduar.
 - 2.Dokumentacioni i i ekspertimit kontabël dhe i administrimit të shoqërisë “Flora&Co” me pretendimet për mashtrim të disa kreditorëve ish-të përndjekur politikë, t’i dorëzohem organit të hetimit.
 - 3.Dokumentacioni dhe procesverbali përkatës i përfundimit të kontrollit dhe administrimit të shoqërisë “Flora&Co” është pjesë e këtij vendimi.
 - 4.Ngarkohet Grupi Mbikëqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta